

E- “Vehabistët” janë të ngjashëm me *keramitët*

J.B. Kelly thotë:

“Në shikim të parë, vehabistët në botën muslimane shiheshin si heretikë, një përshtypje që ushqe hej qëllimisht nga Sherifi i Mekës, i cili frikësohej nga rritja e fuqisë së tyre dhe shpresonte t’i fuste ata në ngatërresë me çifligarin e tij, Sulltanin osman. Një tjetër pikëpamje bashkëkohore i përngjante vehabistët me *keramitët*¹; këta të fundit kishin pasur ndikim në Hasa dhe në Bahrejn, në shekullin e nëntë dhe të dhjetë e.r., dhe konsideroheshin si kamxhiku i Islamit. Në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, kur vehabistët pastruan Hixhazin dhe pushtuan Mekën dhe Medinën, fryma anti-muslimane e kësaj lëvizjeje arriti të jetësohej plotësisht.”²

Komente:

E Para: Kjo analizë e Kellyt është befasuese, sepse *keramitët*, një sekt *shī’itësh*, që në mënyrë të rreptë i kundërvihen Ligjit islamik, i krahason me të ashtuquajturit “vehabistë”, lëvizje e përbetuar suite, që përpiqet t’i rezistojë praktikave që janë futur në Islam dhe ta kthejë Ligjin e Profetit Muhamed, paqja qoftë mbi të. Këto dy grupe kurrsesi nuk mund të jenë të ngjashme. Njëri është grup i devijuar, që kundërshton kredon dhe praktikën e brezave të hershëm të Islamit, ndërsa grupi tjetër mundohet ta ngjallë kredon dhe praktikën e brezave të hershëm të Islamit. Kelly ka rënë në këtë gabim, sepse, sikurse edhe shumë historian përëndimorë, nuk kishte pasur qasje në shkrimet e Ibn Abdul Vehabit apo shënimet autentike historike, që nënkupton mendim të mirë për të (Ibn Abdul Vehabin - sh.p.). Kështu analizën e tij ai e bazon në atë çfarë armiq të Ibn Abdul Vehabit kishin thënë për *da’uen* (thirrjen) e tij. Alfonso Sidio, një historian francez, ka thënë se Ibn Abdul Vehabi i kishte ftuar njerëzit në sjellje të ndershme, ndryshe nga *keramitët*, të cilët kishin sjellje të prishura dhe nuk përfillnin asgjë pos dëshirave të tyre³.

E dyta: Në shumë pjesë të “Mexhmu el-Fetava”, Imam Ibn Tejmijeh, për të cilin orientalistët thonë se kishte pasur ndikim të madh intelektual tek Muhamed Ibn Abdul Vehabi, ka thënë për *keramitët* se:

¹ Një sekt mistik i devijuar i cili ka dalë nga feja Islame.

² “Britain and the Persian Gulf” (Britanikët dhe gjiri persian), nga J.B. Kelly, fq. 48.

³ “Shaikh Muhammad Ibn Abdul-Wahhab: His Salafi Creed and Reformist Movement” (Shejh Muhamed Ibn Abdul Vehabi: Kredoja e tij selefite dhe lëvizja reformiste) nga gjykatësi Ahmed Ibn Haxher el-Butami, fq.150.

- “Janë rafidi.”⁴ ⁵

Muhamed Ibn Abdul Vehabi ishte kundërshtar i palëkundur i metodologjisë së rafidive. Ai thotë: “Rafidhat (shi’itët- sh.p.) ishin të parët që futën shirkun (politeizmin) në këtë ummet (tek muslimanët).⁶”

- “Ata e bëjnë haram sheriatin.”⁷

Muhamed Ibn Abdul Vehabi dhe pasuesit e tij kishin ngjallur sheriatin “...Sheriatin e kishin si kushtetutë të tyre, kod penal dhe bazë për kodin civil të tyre.”⁸

- “Ata mohojnë ekzistencën e Krijuesit.”⁹

Muhamed Ibn Abdul Vehabi kishte ngjallur *teuhidin* e Krijuesit duke e mbrojtur atë (besimin në njësinë e Zotit- sh.p.) kundër çdo metode të politeizmit “Theks të madh i jepte teuhidit (Njësisë së Zotit) dhe mohonte shirkun (politeizmin) në çdo formë, sikurse vërehet në kryeveprën e tij *Kitab el-Teuhid*.¹⁰”

- “Kredoja e tyre detyron mohimin e të gjitha Librave (Hyjnore) dhe të gjithë të Dërguarve.”¹¹

Muhamed Ibn Abdul Vehabi i besonte të gjitha shtyllat e besimit islamik, dhe thotë: “Unë besoj në atë çfarë *Ehlu es-Sunneh uel-Xhemah* besojnë, e ai është besimi në Allah dhe në Engjëjt e tij, në Librat, në të Dërguarit, në Ringjalljen pas vdekjes dhe në besimi në *Kader* (paracaktim).¹²”

- “Ata janë *batinijeh*”¹³ ¹⁴

“Muhamed Ibn Abdul Vehabi i jepte theks njësisë së Zotit si kundërvënie ndaj shirkut, apo politeizmit, që definohet si shoqërim i ndonjë personi apo objekti në fuqitë që duhet

⁴ Sekt *shi’itësh*.

⁵ Vëll. 4, fq. 422.

⁶ “Shejh Muhamed Ibn Abdul Vehabi” nga gjykatësi el-Butami, fq. 48.

⁷ Vëll. 5, fq. 545.

⁸ “Inside the Arab World” (Brenda botës arabe) nga Michael Field, fq. 182.

⁹ Vëll. 2, fq. 160.

¹⁰ “The Wahhabi Movement in India” (Lëvizja vehabite në Indi), nga Kijamudin Ahmed, fq. 28.

¹¹ Vëll. 2, fq. 129.

¹² “Shaikh Muhammad Ibn Abdul-Wahhab: His Salafi Creed and Reformist Movement” (Shejh Muhamed Ibn Abdul Vehabi: Kredoja e tij selefite dhe lëvizja reformiste) nga gjykatësi el-Butami, fq.42-7; “Correcting a Historical Mistake About the Wahhabiyah” (Korrigjimi i gabimit historik rreth Vehabizmit) nga Dr. esh-Shuveir, fq.107-10.

¹³ Mistikë.

¹⁴ “Mexhmu el-Fetava” vëll. 2, fq. 134.

atribuuar vetëm Zotit. Ai dënonte disa veprime specifike, të cilat ai i shihte si shteg që shpijnë në shirk, sikurse janë kurbanet për hir të ndonjë njeriu, falja në varreza apo tyrbe, dhe çdo lutje në të cilën futej pala e tretë si ndërmjetësuese me Zotin. Posaçërisht, zëri ngrihej kundër kremtimit të ditëlindjes së Profetit, ceremonive vajtores të shi'itëve dhe misticizmit të sufive.¹⁵

E treta: Idetë dhe pikëpamjet e perëndimorëve bazohen kryesisht në shkrime të gjymta, siç janë ato të J.B. Kelly, të cilit i mungon njohuria në Islam, fe të cilën vetë ai nuk e beson dhe e përshkruan lëvizjen reformiste fetare të muslimanëve, që përpiqet ta ngjallë kredon dhe ligjin islamik, si lëvizje me karakter anti-musliman.

¹⁵ "Library of Congress Country Studies".